



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 30.12.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HEC GRABOVA 2,  
NË PELLGUN E PËRROIT TË GRABOVËS”,  
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË GRAMSH, QARKU ELBASAN

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “H.K Hec Grabova 2” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, Hec Grabova 2, në pellgun e Përroit të Grabovës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”, me subjekt zhvillues shoqërinë “H.K Hec Grabova 2” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a. plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
  - b. pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Gramsh.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

  
BELINDA BALLUKU



  
ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

